

University for Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Fall 11-2016

ROLI DHE NDIKIMI I KAPITALIT NJERËZOR NË INVESTIMET E HUAJA DIREKTE

Rahman Krasniqi

University for Business and Technology - UBT

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Business Commons](#)

Recommended Citation

Krasniqi, Rahman, "ROLI DHE NDIKIMI I KAPITALIT NJERËZOR NË INVESTIMET E HUAJA DIREKTE" (2016). *Theses and Dissertations*. 1138.

<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/1138>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact knowledge.center@ubt-uni.net.



Kolegji UBT
Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

**ROLI DHE NDIKIMI I KAPITALIT NJERËZOR NË INVESTIMET E
HUAJA DIREKTE**
Shkalla Bachelor

Rrahman Krasniqi

Nëntor / 2016
Prishtinë



Kolegji UBT
Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

Punim Diplome
Viti akademik 2010-2011

Rrahman Krasniqi

**ROLI DHE NDIKIMI I KAPITALIT NJERËZOR NË INVESTIMET E
HUAJA DIREKTE**

Mentori: Prof. Dr. Nazmi Zeqiri

Nëntor / 2016

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të
pjeshme për Shkallën Bachelor

ABSTRAKT

Investimet e Huaja Direkte janë një fenomen relativisht i ri, i cili ka patur një zhvillim të hovshëm në rritje në vitet në vazhdim. Nxitur nga ndryshimi teknologjik, konkurrenca globale dhe liberalizimi i tregjeve, investimet e huaja direkte luajnë një rol kyç në procesin e integritit global ekonomik. Ato krijojnë efekte si në vendet pritëse ashtu dhe në ato investuese. Efektet në vendet pritëse janë të rëndësishme si për nga shumëllojshmëria e tyre ashtu dhe për nga rëndësia ekonomike, politike dhe sociale që ato gjenerojnë. Përfitimi i këtyre efekteve nuk vjen automatikisht por ndikohet nga realizimi i disa kushteve specifike. IHD-të sjellin kapitalin e nevojshëm, rritin produktivitetin e ekonomisë nëpërmjet transferimit të njohurive dhe teknologjisë, ndikojnë në hapjen e tregjeve të reja për tregti, rrisin konkurrueshmërinë e ekonomisë, ndikojnë në reduktimin e deficitit të llogarive korente, rrisin punësimin dhe mbi të gjitha ndikojnë në mirëqenien e popullsisë.

Një nga problemet ekonomike të vendeve të pazhvilluara dhe Kosovë është se ato nuk kanë kursime të mjaftueshme kombëtare për të financuar investimet e tyre. Ato janë në nevojë të vazhdueshme të kapitalit të huaj në format e dy investimeve direkte dhe indirekte. Investimet e Huaja Direkte (IHD) janë marrë për të përfituar një vend i varfër si Kosova, jo vetëm duke plotësuar investimet e brendshme, por edhe në aspektin e zhvillimit ekonomik, transferimin e teknologjisë, rritjen e konkurrencës etj.

Në këtë mënyrë, kapitali njerëzor është një përcaktues i rëndësishëm dhe një parakusht për tërheqjen e investimeve në një vend. Në këtë studim i jepet në përshkrim Investimeve të Huaja Direkte definimi i Investimeve të Huaja Direkte, ndarja e IHD-ve, po ashtu hulumton klimën e investimeve në Kosovë, parë nga investitorët e huaj, nivelin e tyre të kënaqësisë ose pakënaqësisë me investimet e tyre dhe kapitalin njerëzor, faktorët që ndikojnë zgjedhjen e Kosovës si një destinacion për investime, barrierat dhe ndryshimet arsimore të nevojshme që duhet të ndërmerren në mënyrë që të bëjë kapitalin njerëzor të përshtatshëm për nevojat e investitorëve të huaj.

MIRËNJOHJE DHE FALENDERIME

Unë do të doja të fillojë tezën time me falendërimin për të gjithë ata që më ndihmuan dhe më dhanë kurajë të realizojë Punimin e Diplomës së Bachelor-it në drejtimin Banka, Financa dhe Kontabilitet.

Një falënderim të veçantë do t'ia shprehja mentorit të punimit të diplomës sime, Profesor Nazmi Zeqirit i cili kontribuoi në ngritjen time profesionale sikurse profesor dhe tani dëshmoi ndihmë, përkrahje dhe profesionalizëm aq të madh me këshillat dhe punën e tij, duke më ndihmuar ta finalizoj punimin tim të diplomës.

Pa lënë anash do të dëshiroja ta falënderoja familjen time, të cilët dhanë kontribut maksimal për arritjen e aspiratave të mija.

Ju falënderoj të gjithëve me plot sinqeritet!

PËRMBAJTJA

| | |
|---|-----------|
| LISTA E FIGURAVE..... | IV |
| LISTA E TABELAVE | V |
| FJALORI I TERMAVE | VI |
| 1. HYRJE..... | 1 |
| 2. SHQYRTIMI I LITERATURËS | 3 |
| 2.1 PËRKUFIZIMI I INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE (IHD)..... | 3 |
| 2.2 KLASIFIKIMI I INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE (IHD) | 5 |
| 2.3 INVESTIMET E HUAJA DIREKTE DHE MËNYRA E HYRJES NË NJË TREG TË HUAJ..... | 6 |
| 2.4 PËRPARSITË E INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE (IHD) | 8 |
| 2.5 TË METAT E INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE (IHD) | 10 |
| 3. DEKLARIMI I PROBLEMIT | 12 |
| 4. METODOLOGJIA | 16 |
| 5. PREZANTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE | 17 |
| 5.1 ECURIA E INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE NË KOSOVË | 17 |
| 5.2 PROMOVIMI I KOSOVES SI VEND PËR INVESTIME..... | 18 |
| 5.3 SHPËRNDARJA E INVESTIMEVE SIPAS SEKTORËVE..... | 20 |
| 5.4 SHPËRNDARJA E INVESTIMEVE SIPAS SHTETEVE | 21 |
| 5.5 INVESTIMET E HUAJA DIREKTE DHE ROLI I KAPITALIT NJERËZOR | 23 |
| 5.6 KAPITALI NJERËZOR DHE LIDHJA ME INVESTIMET E HUAJA DIREKTE | 23 |
| 6. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIMET | 30 |
| 7. REFERENCAT | 32 |

LISTA E FIGURAVE

| | |
|--|----|
| Figura 1. Rëndësinë dhe prioritizimin e kapitalit njerëzor në procesin e vendimmarrjes për të investuar në Kosovë..... | 24 |
| Figura 2. Arsyet për të investuar në Kosovë. | 25 |
| Figura 3. Barrierat që mund të zvogëlojnë numrin e kompanive që mund të investojnë në Kosovë..... | 25 |
| Figura 4. A duhen trajnime shtesë për punëtorët e rinjë në kompanitë që bëjnë investime të huaja direkte (IHD)..... | 26 |
| Figura 5. Në procesin e punësimit të kandidatëve në Kosovë kë do të punsëonit të parin. . | 27 |
| Figura 6. Roli dhe ndikimi i kapitalit njerëzor në investimet e huaja direkte. | 28 |
| Figura 7. Ndryshimet që duhet të bëhen në sistemin e arsimit rekomanduar nga institucionet që investojnë në Kosovë. | 28 |

LISTA E TABELAVE

| | |
|--|----|
| Tabela 1. Investimet e huaja direkte 2007 –2015 (në mil EUR) | 18 |
| Tabela 2. Investimet e huaja direkte 2007 - 2015 sipas sektorëve (vlera në ml E)..... | 21 |
| Tabela 3. Investimet e huaja direkte 2007 –2015 sipas vendit të origjines (në mil EUR). .. | 22 |

FJALORI I TERMAVE

IHD - Investimet e Huaja Direkte

NSH - Ndërmarrje shoqërore

NP - Ndërmarrje Publike

UNCTAD - United Nations Conference on Trade and Development

GDP - Gross Domestic Product

OECD - Organization for Economic Cooperation and Development

FMN-Fondi Monetar Ndërkombëtar

APIK - Agjencia për Promovimin e Investimeve

BE - Bashkimi European

CEFTA - The Central European Free Trade Agreement

TVSH – Tatimi mbi vlerën e shtuar

1. HYRJE

Në këtë kapitull do të paraqitet një pamje e përgjithshme në pika të shkurta për punimin dhe qëllimin e këtij punimi.

Investimet e Huaja Direkte (IHD) janë një fenomen relativisht i ri, i cili është i dukshëm që në shekullin e XIX në formën e kreditimit që ekonomia angleze bën për të financuar zhvillimin ekonomik në vende të ndryshme si dhe në formën e pronësisë mbi aktivet financiare. Në periudhën midis dy luftërave në shekullin e XX investimet e huaja patën një rënie të konsiderueshme. Mbarimi i luftës së Dytë Botërore shënoi dhe lulëzimin e fenomenit të IHD-ve për dy arësye themelore. Së pari, zhvillimi i teknologjisë favorizoi transportin dhe komunikacionin gjë që krijoi mundësinë e kontrollit në distancë si kusht për zhvillimin e IHD-ve. Së dyti, vendet e Evropës dhe Japonia kishin nevojë për kapitalin e SHBA për rikonstrukcion. Nxitur nga ndryshimi teknologjik, konkurrenca globale dhe liberalizimi i tregjeve, investimet e huaja direkte luajnë një rol kyç në procesin e integritit global ekonomik.

Trendi i vertetë i tërheqjes së investimeve të huaja direkte ka filluar vetëm në fund të viteve 1980 dhe fillim të viteve 1990, kur procesi filloi kur ndodhi ndryshimi nga ekonomi e planifikuar në ekonominë e tregut, dhe si pasojë shumë ekonomi u përballën me një mungesë të kapitalit vendas. Një ndikim të madh në rritjen e investimeve të huaja direkte (IHD) kishte privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore (NSH) dhe ndërmarrjeve publike (NP), si pjesë e procesit të transformimit në ekonominë e tregut.

Që atëherë, në tridhjetë vitet e fundit, rëndësia e IHD-ve është në rritje, veçanërisht në tranzicion dhe vendet në zhvillim. Megjithë rritjen dramatike të fluksit të kapitalit, veçanërisht në formën e IHD-ve, janë të drejtuara vetëm në një numër të kufizuar të vendeve. Çfarë faktorë bëjnë që një investitor i huaj të zgjedh një vend të veçantë për të bërë investime. Lista është shumë e gjatë, por ajo ka një parakusht - kapitalin njerëzor në vendin pritës, vendet e varfra si Kosova, si dhe vendet e zhvilluara që duan të kenë

investitorë seriozë të huaj, duhet të nxisin nivelin e aftësive dhe kompetencave lokale dhe për të ndërtuar aftësitë e kapitalit njerëzor.

Praktika e tërheqjes së IHD-ve në përgjithësi përfshin stimuj të shumta fiskale dhe monetare. Megjithatë, duhet të theksohet se tërheqja e IHD-ve duhet të jetë shoqëruar me zhvillimin dhe rritjen e nivelit të kapitalit njerëzor, si një parakusht për të tërhequr drejtë investimet e huaja.

Studimi është strukturuar në kapituj. Fillimisht jepet një prezantim i Investimeve të Huaja Direkte në aspektin teorik. Niset me përkufizimet e ndryshme që i bëhen IHD-ve, jepet një klasifikim i IHD-ve sipas veçorive dhe vazhdohet me listimin e faktorëve që i përcaktojnë, po ashtu ceket edhe rëndësia e Investimeve në vende të ndryshme, arsyen se përse duhet shtetet e tjera të investojnë në Kosovë. Vazhdon me ecurinë e IHD-ve në Kosovë ku flitet për investimet e huaja direkte ndër vite, po ashtu edhe për shtetet që kanë investuar më së shumti në Kosovë përgjatë këtyre viteve.

Në fund analizohet ndikimi i kapitalit njerëzor në investimet e huaja direkte parë nga këndvështrimi i kompanive të ndryshme, dhe ndryshimet që duhet të bëhen në sistemin arsimor për promovimin sa më të madh të Kosovës për përfitimin e IHD-ve. Të dhënat e prezantuara janë shqyrtuar nga literatura të ndryshme dhe nga hulumtimi i realizuar nga Prof.Dr. Nazmi Zeqiri. Shqyrtimi ka të bëjë me investimet e huaja direkte në përgjithësi por në veqanti për investimet e huaja direkte në Republikën e Kosovës.

2. SHQYRTIMI I LITERATURËS

Ky kapitull është ndarë në disa pjesë që ndihmojnë për të krijuar kuadrin teorik të të gjithë punimit në mënyrë të qartë dhe logjike, ku është shqyrtuar literature ku përfshihen investimet e huaja direkte, perkufizimi i investimeve të huaja direkte, klasifikimi i investimeve të huaja direkte, llojet e investimeve të huaja direkte dhe në fundë përparsitë dhe të metat e investimeve të huaja direkte.

Investimet e Huaja Direkte (IHD) janë një element kyç në integrimin ekonomik ndërkombëtar. Ato krijojnë lidhje të drejtëpërdrejta, të qëndrueshme dhe afatgjate ndërmjet ekonomive, dhe lejojnë ekonomitë të promovojnë produktet e tyre në tregjet ndërkombëtare. IHD janë gjithashtu një burim shtesë financimi për investime, të cilat të ndihmuara nga politikat e duhura mund të jenë një mjet i rëndësishëm për zhvillim. Si pjesë e GDP në llogaritë kombëtare të një vendi, dhe në lidhje me ekuacionin e të ardhurave kombëtare.

Investime nga një vend në një tjetër që përfshin krijimin e operacioneve apo blerjen e pasurive të prekshme, duke përfshirë aksione në biznese të tjera, blerja apo krijimi i aseteve të gjenerimit të të ardhurave në një vend të huaj që përfshin kontrollin e operacionit ose organizatës.

IHD përcaktohet si rrjedhja neto e investimeve (rrjedhja e brëndshme minus rrjedhje e jashtme) për të blerë një interes menaxhues afatgjatë (10% apo më shumë të stokut votues), në një entitet (ndërrmarrje) që vepron në një vend të ndryshëm nga ai e investuesit.

IHD është shuma e kapitalit të vet, të tjera kapitale afatgjatë, të tjera kapitale afatshkurtër, siç paraqiten në bilancin e pagesave. Zakonisht IHD përfshijnë pjesëmarrjen në menaxhim, joint-venture, transferim të teknologjisë dhe të mjeshtërive (njohurive eksperte).

2.1 Përkufizimi i Investimeve të Huaja Direkte (IHD)

Nëse duhet të japim një përkufizim të caktuar se çfarë janë Investimet e Huaja Direkte, do të shohim se është e vështirë për t'i dhënë një përgjigje gjithëpërfshirëse dhe shteruese. Një

nga shkaqet kryesore të shumëllojshmërisë së përkufizimeve të IHD-ve është fakti se investitorët e huaj, në vende të ndryshme, kanë karakteristika të ndryshme, si dhe operojnë në përputhje me kuadrin legjislativ dhe rregullator të vendeve të tyre që mund të jetë i ndryshëm nga kuadrin legjislativ dhe rregullator i vendeve pritëse (*Moosa, 2002*).

Investimet e Huaja Direkte janë shumë më komplekse për nga natyra sesa investimi portofol, pasi shpesh herë ato përfshijnë edhe transferimin e mjeteve bazë siç janë njohuritë teknologjike, dhe aftësitë menaxheriale dhe organizative. Për rrjedhojë, përkufizimi i Investimeve të Huaja Direkte nga ana praktike nuk mund të shqyrtohet i veçuar nga përkufizimi i kompanive shumëkombëshe, i cili, gjithashtu, nga ana e tij, është i vështirë për t'u përkufizuar.

Investimet e Huaja Direkte përkufizohen si një investim nga një njësi ekonomike (entitet) rezident (investitor direkt), me objektivin e sigurimit të një interesi të qëndrueshëm, në një njësi ekonomike rezidente në një vend tjetër (njësia e investimit direkt). Interesi i qëndrueshëm kupton ekzistencën e një lidhjeje afatgjatë ndërmjet investitorit direkt dhe njësisë ku investohet (njësisë së investimit direkt) si dhe një shkallë influence domethënëse nga investitori direkt në menaxhimin e njësisë. Kriteri kryesor i përdorur është pronësia e të paktën 10% të fuqisë votuese (*Moosa, 2002*).

Investimet e Huaja Direkte dallohet nga investimet e huaja të portofolit (blerjen e letrave me vlerë të një vendi nga një shtetas të një vendi tjetër) nga elementi i kontrollit. Përkufizime standarde të kontrollit të përdorimit të rënë dakord ndërkombëtarisht paguan 10% të aksioneve votuese, por kjo është një zonë që shpreh një bllok të vogël të aksioneve ku i japin kontroll në kompanitë e mbajtura. Për më tepër, kontrolli i teknologjisë, menaxhimit, madje edhe inpute të rëndësishme mund të japë kontroll de facto.

Në bazë të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), Investimet e Huaja Direkte përkufizohen si: ndërmarrjet që janë të përfshira ose të papërfshira në të cilën një investitor i huaj zotëron 10 për qind ose më shumë të aksioneve të zakonshme ose fuqisë votuese të një ndërmarrjeje të inkorporuar ose ekuivalenti i një ndërmarrjeje të painkorporuar, ose thënë ndryshe udhëzimet numerike të pronësisë së 10 për qind të aksioneve të zakonshme ose aksioneve të votimit përcakton ekzistencën e një marrëdhënie

të investimit direkt. Një zë efektiv në menaxhimin, siç dëshmohet nga një pronësi të të paktën 10%, nënkupton që investitori direkt është në gjendje të ndikojë ose të marrë pjesë në menaxhimin e ndërmarrjes; ajo nuk kërkon kontroll absolut nga ana e investitorit të huaj.

Përkufizimet kryesore i Investimeve të Huaja Direkte i gjejmë te Manuali i Bilancit të Pagesave të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe te Raporti Botëror i Investimeve i Kombeve të Bashkuara i vitit 1999. Sipas Manualit të Bilancit të Pagesave të Fondit Monetar Ndërkombëtar Investimet e Huaja Direkte janë një kategori e investimeve ndërkombëtare, të cilat pasqyrojnë sigurimin e të ardhurave të qëndrueshme nga një subjekt rezident i një ekonomie në një subjekt që është rezident në një ekonomi tjetër dhe ka një shkallë të konsiderueshme të ndikimit në menaxhimin e këtij të fundit. Raporti Botëror i Investimeve i Kombeve të Bashkuara i përcakton IHD-të si “një investim që përfshin një marrëdhënie afatgjate, që pasqyron një interes të qëndrueshëm dhe kontroll të një subjekti vendas në një ekonomi (investitor direkt i huaj ose sipërmarrje mëmë) në një sipërmarrje vendase në një ekonomi të ndryshme nga ajo e investitorit direkt të huaj (sipërmarrja IHD, sipërmarrja degë ose dega e huaj).

2.2 Klasifikimi i Investimeve të Huaja Direkte (IHD)

Ashtu si përkufizimi i tyre, edhe klasifikimi i IHD-ve varet nga këndvështrimi nga të cilat ato studiohen. Dy janë këndvështrimet kryesore të shikimit të IHD-ve:

- 1) Nga këndvështrimi i investitorit
- 2) Nga këndvështrimi i vendit pritës

Nga këndvështrimi i investitorit, IHD-të klasifikohen në 1)horizontale, 2)vertikale, 3)konglomerat dhe 4)burim kërkuese.

1. Investimet e Huaja Direkte horizontale - Prodhohet jashtë (ne vendin pritës) ajo që prodhohet dhe në kompaninë mëmë. Pra, i njëjti standart prodhimi duplikohet dhe jashtë vendit. Ky lloj Investimi i Huaj, paraqet tipologjinë më të përhapur të IHD-ve. Zakonisht IHD-të horizontale, të cilat quhen edhe kërkimi i tregut, operojnë në

ato vende ku madhësia e tregut është e madhe dhe fuqia blerëse është e konsiderueshme nga ana e konsumatorëve.

2. Investimet e Huaja Direkte Vertikale- Transferohet jashtë një nga fazat e procesit prodhues. Ky lloj Investimi është më i përhapur në sektorët dytësor dhe tretësor, siç janë industritë përpunuese. IHD-të vertikale kërkojnë të përdorin edhe teknologjinë e përparuar nëse përdorimi i tyre minimizon koston e prodhimit, IHD-të vertikale synojnë eksportin e produkteve nga vendi mëmë në vendin pritës.
3. Investimet e Huaja Direkte konglomerat - që janë një përzierje e investimeve horizontale dhe vertikale, të cilat përfshijnë edhe investimin në një industri të një natyre tjetër në vendin pritës. Këto investime të huaja përqendrohen kryesisht në vende të cilat janë të pasura me burime natyrore. Qëllimi i tyre parësor është shfrytëzimi i atyre burimeve që nuk ndodhen në vendet e tyre ose që janë në pronësi të konkurrentëve të tjerë.
4. Investimet e Huaja Direkte burim kërkuese. Këto investime të huaja përqendrohen kryesisht në vende të cilat janë të pasura me burime natyrore. Qëllimi i tyre parësor është shfrytëzimi i atyre burimeve që nuk ndodhen në vendet e tyre ose që janë në pronësi të konkurrentëve të tjerë. Në rastin e Shqipërisë, me interes nga investitorët e huaj shihet shfrytëzimi i rezervave minerale, pyjore, të naftës dhe të energjisë elektrike (*Lipsey, 2003*).

2.3 Investimet e Huaja Direkte dhe mënyra e hyrjes në një treg të huaj

Firmat mund të hyjnë në ekonomi pritëse si investim i huajë me anë të investimeve nga fillimi ose nga bashkimet dhe blerjet. Një investim nga fillimi ndodh kur një firmë, si e vetme ose së bashku me një firmë tjetër, (d.m.th., në një sipërmarrje të përbashkët) fillon aktivitet të ri në vendin pritës. Një blerje ndodh kur një firmë blen nga një pjesë (d.m.th., blerje e pjesshme) ose tërë kapitalin (d.m.th., blerje e plotë) e një firme të synuar në një vend pritës.

Në përgjithësi, IHD-të mund të marrin një nga këto tri forma: investime nga fillimi (ang.Greenfield), bashkime ose blerje shoqërishe (ang.Mergers and Acquisitions), si dhe krijime të shoqërive të përbashkëta (ang.Joint Ventures).

- **Investimet nga fillimi** (ang.Greenfield) nënkuptojnë kryerjen e investimeve nga fillimi në vendin pritës. Investimet nga fillimi synojnë prodhimin e të mirave dhe të shërbimeve me kosto më të ulët, duke shfrytëzuar kapacitetet prodhuese të vendit pritës. Ato përkrahen nga vendet pritëse, pasi nxisin hapjen e vendeve të reja të punës, kualifikimin e mëtejshëm të punonjësve dhe ndikojnë në transferimin dhe në përshtatjen e teknologjisë. Këto investime shërbejnë si motivim edhe për kompanitë vendase të vendeve pritëse, duke ndikuar në rritjen e konkurrencës në vend. Bazuar në numrin e madhë të të pa punëve në Kosovë, investimet nga fillimi (Greenfield) do të ishin të mirseardhuara dhe shumë të përshtatshme.
- **Bashkimi ose blerja e firmave ekzistuese** (ang.Mergers and Acquisitions) në vendin pritës. Kur firmat ndodhen në vështirësi financiare ose kur duan të fuqizohen më shumë nëpër tregje, mund të ndodhë që dy ose më shumë firma të bashkohen në një të vetme. Forma më e zakonshme e bashkimeve dhe e blerjeve synohet nga firmat e vendeve të zhvilluara. Korporatat e mëdha kryejnë blerje të firmave të tjera (zakonisht në vendet pritëse) për arsye zgjerimi. Bashkimet e firmave më së shumti ofrojnë përparësi pozitive, pasi rrisin efikasitetin, ulin kostot e prodhimit dhe kanë mundësi zgjerimi në tregun ndërkombëtar. Përfitimi më i madhë nga ky lloj i Investimeve është se rritë produktivitetin e fuqisë punëtore, por nuk ndikon në uljen e papunësisë (*H.Shenkar, 2007*).
- **Shoqërit e përbashkëta** (ang.Joint Ventures) krijohen kur dy ose më shumë individë ose subjekte lidhen së bashku në një marrëveshje kontraktuale për sipërmarrjen e një biznesi, duke ndarë fitimet dhe humbjet. Bashkimi i firmave bëhet për të patur fitime më të mëdha, por nga ana tjetër ato mund të kenë edhe implikime të konsiderueshme. Një partneritet zakonisht synon vazhdimësinë e marrëdhënies afatgjatë të biznesit, ndërsa një ndërmarrje e përbashkët bazohet në një projekt të vetëm të biznesit. Si përparësi kryesore, që mbartin ndërmarrjet e përbashkëta, mund të përmendim aftësinë e tyre për t'u përshtatur. Gjithashtu,

kompanive u ofrohet mundësia e shfrytëzimit të kapaciteteve të reja, mundësia për të hyrë në tregjet financiare të vendit pritës ose për të fituar njohuri të reja teknologjike përfshirë edhe personelin e specializuar, si dhe fitimin e emrit të mirë të një firme, me të cilin ajo mund të përmirësojë shitjet nëse qëllimi i investimeve është t'u shërbejnë tregjeve lokale. Rëndësia e zhvillimit të kapitalit njerëzor në sipërmarrjet e përbashkëta ndryshon në vendet e zhvilluara në krahasim me vendet në tranzicion dhe vendet e pa zhvilluara (Lim, 2001).

2.4 Përparsitë e Investimeve të Huaja Direkte (IHD)

Një nga përparsitë e investimeve të huaja direkte është se ajo ndihmon në zhvillimin ekonomik të vendit ku derdhen ato investime të huaja. Investimet e Huaja Direkte zakonisht gjejnë zbatim në vendet në zhvillim. Gjatë viteve '90-ta, Investimet e Huaja Direkte ishin një nga burimet kryesore të financimit të jashtëm për shumicën e vendeve që kishin një prespektivë të rritjes ekonomike. IHD-të gjithashtu kanë ndihmuar disa vende kur ato janë përballuar me vështirësi ekonomike. Investimet e huaja direkte gjithashtu lejojnë edhe transferimin e teknologjive.

Vendet që kanë marrë investime të huaja direkte nga një vend tjetër, mund të zhvillojnë Kapitalin Njerëzor të tyre, duke punësuar njerëz të rinjë, në veprimtarinë e ndonjë biznesi të veçantë. Fitimet që gjenerohen nga investimet e huaja direkte të cilat janë bërë në atë vend, mund të përdoren me qëllim të bërjes së kontributeve për taksat mbi të ardhurat e korporatave të vendit marrës. Më posht do të cekim disa nga përparsitë e Investimeve të Huaja Direkte.

- Një ndër përfitimet më të dukshme është që lejon që paraja të qarkullojë lirisht për të mundësuar që biznesi të operojë atje ku është prespektiva më e mirë për rritje, kudo në botë. Ekonomistët tentojnë të favorizojnë qarkullimin e lirë përtej kufijve sepse lejohet që kapitali të kërkojë kthim më të lartë. Kjo sepse investitorët kërkojnë gati në mënyrë agresive kthimin më të mirë për paratë e tyre me rrezikun më të ulët të mundshëm. Për përmbushjen e këtij qëllimi, nuk merret parasysh asgjë, as feja

dhe as forma e qeverisjes. Kjo u krijon bizneseve një ecuri të mirë, që përkthehet në një avantazh krahasues.

- Paratë lëvizin në të gjithë botën drejt përdorimit më të mirë të tyre duke sjellë mallra dhe shërbime në treg më shpejt sesa po të mos ekzistonin IHD.
- Fluksi ndërkombëtar i kapitalit ul riskun me të cilin ballafaqohen pronarët e kapitalit duke i lejuar ata të diversifikojnë huadhëniet dhe investimet e tyre. Ata ulin riskun nëpërmjet diversifikimit jashtë në një vend specifik, në një industri specifike apo në një sistem politik specifik. Diversifikimi rrit gjithnjë kthimet pa rritur riskun.
- Pritësit përfitojnë duke marrë eksperiencë në menaxhim, kontabilitet apo praktika ligjore nga praktikat më të mira që u mundësohen nga huadhenësit e tyre.
- Shtetet të cilët përfitojnë nga Investimet e huaja direkte gjithashtu mund të inkorporojnë teknologji të reja, inovacione në praktikat operacionale si dhe mjete të reja financimi.
- Përmirësohet stili i jetës së punonjësve në ndërmarrjet e investimeve të huaja, duke i ndihmuar ata të sigurojnë një standart më të mirë jete në vendet e tyre. Përgjithësisht pagat dhe shpërblimet në kompanitë e huaja janë më të larta se në ato vendase.
- Detyrojnë në një farë masë qeveritë lokale (që nuk kanë shumë influencë në politikat e brendshme të aplikuara nga ndërmarrjet e huaja) të mos zbatojnë politika “të varfra”, por të ndjekin trendin.
- Standarti i jetës në vendet pritëse përmirësohet gjithashtu nga shtimi i taksave që vjelin qeveritë nga investimet e huaja direkte. Por disa herë ky efekt edhe mund të neutralizohet nëpërmjet stimujve që qeveritë ofrojnë për tërheqjen e IHD-ve.
- Një tjetër avantazh i IHD-ve është fakti se ato mund të kompesojnë paqëndrueshmërinë e krijuar nga “paratë e nxehta”. Huadhenësit afatshkurtër dhe tregtarët e valutës mund të krijojnë një “fluskë aktive” në një vend, duke investuar shumë para për një periudhë të shkurtër kohe dhe pastaj i shesin investimet e tyre. Kjo mund të krijojë një cikël që mund të dobësojë regjimin politik dhe ekonomik të vendit. Investimet afatshkurtra janë gjithashtu më të ndjeshme ndaj ndryshimeve politike apo të cfarëdo lloji tjetër duke u larguar më lehtësisht nga

vendet ku është investuar. IHD-ve për vetë natyrën e tyre u duhet më shumë kohë për t'u vendosur dhe janë më të qëndrueshëm. Ato lënë gjurmë në një vend.

2.5 Të metat e Investimeve të Huaja Direkte (IHD)

Të metat e investimeve të huaja direkte ndodhin kryesisht në rastin e qështjeve që lidhen me funksionimin dhe shpërndarjen e profitit nga investimet e huaja. Një e metë tjetër e investimeve të huaja direkte është se sektorët e pazhvilluara ekonomikisht të vendit pritës janë gjithmonë të papërshtatshëm kur niveli i investimeve të huaja direkte ndikon në mënyrë negative.

Investimet e huaja direkte përmbajnë në vete shpenzime të larta të komunikimit, udhëtimit etj. Dallimet gjuhësore dhe kulturore që ekzistojnë në mes të vendit të investitorit dhe vendit pritës, gjithashtu, mund të paraqesin probleme në rastin e investimeve të huaja direkte. Megjithatë, një tjetër e metë e investimeve të huaja direkte është se ekziston gjithmonë mundësia e dështimit në pronësinë e një kompanie që ka në ndonjë kompani jashtë. Disa nga të metat tjera të investimeve të huaja direkte mund të jenë:

- Kompanitë me pjesëmarrje të huaja mund të përqendrohen në sektorë strategjik të rëndësishëm dhe mund të krijojnë çrregullime si në nivel sektorial ashtu dhe atë gjeografik.
- Mund të ndodhë që investitorë të sofistikuar të përdorin njohuritë dhe mjeshtritë që gjejnë në kompani pa u shtuar vlerë atyre. Në një aspekt më të gjerë investitorët e huaj specializojnë krahun e punës duke e përshtatur me nevojat e tyre dhe duke krijuar një nivel afësimi më të ulët sesa po të punësoheshin në sipërmarrje vendase me programe premtuese të menaxhimit të burimeve njerëzore.
- Ata mund t'u shesin investitorëve vendas më pak të sofistikuar një pjesë të kompanisë që nuk sjell përfitime.
- Investitorët mund t'u japin hua kompanive lokale kundrejt kolateraleve dhe të drejtojnë fondet tek kompania mëmë jashtë.

- Riatdhesimi i fitimeve të gjeneruara tek kompanitë mëmë krijojnë vështirësi në bilancin e pagesave të vendit pritës.
- Ekonomitë e vendeve në zhvillim, gjithmonë e më shumë të varura nga IHD-të (që në të shumtën e rasteve shkojnë drejt vendeve që ofrojnë kosto të ulët), janë edhe gjithmonë e më shumë të ndjeshme ndaj mbylljes së fabrikave, nëse monedha vendase pëson një mbivlerësim të shpejtë ose pagat vendase rriten ndjeshëm.
- Investimet e huaja përbëjnë një kapital që shfrytëzohet nga vendet pritëse. Duhet pasë kujdes që raporti “kapital i huaj/kapital vendas” të mos jetë shumë i madh sepse në rast të kundërt kjo krijon varësi të vendit pritës nga investimi i huaj. Veçanërisht kur burimi i investimit vjen nga i njëjti vend, atëherë rreziku që këto investitorë të ndikojnë në politika apo vendimmarrje të qeverisë pritëse është akoma më i dukshëm.
- Transferimi i teknologjive më të vjetra apo i proceseve më të dëmshme në vendet ku investohet ka ndikuar në ndotjen e mjedisit në ato vende që nuk kanë politika të mirëpërcaktuara për mbrojtjen e mjedisit apo ku aplikimi i ligjit lë akoma për të dëshiruar për shkak të brishtësisë së institucioneve.

3. DEKLARIMI I PROBLEMIT

Me një ritëm në rritje të globalizmit që rezultoi pjesërisht nga liberalizimi i regjimit të tregtisë dhe të kursit të këmbimit, vëllimi i investimeve të huaja direkte është rritur në të gjithë botën. Në dekadat e fundit, investimet e huaja kanë qenë në rritje me një ritëm që tejkalon volumin e tregtisë ndërkombëtare. Sipas të fundit, të vitit 2015 raporti i investimeve në Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin (UNCTAD), flukset globale të IHD-ve kanë rënë në vitin 2014, investimet e huaja direkte globale (FDI) flukset hyrëse kanë rënë me 16 për qind në \$ 1.23 trilion në vitin 2014, kryesisht për shkak të brishtësisë së ekonomisë globale, pasiguria e politikave për investitorët dhe ka ngritur rreziqet gjeopolitike. Investimet e reja janë kompensuar edhe nga disa likuidime të mëdha. Brendshëm rrjedh IHD për ekonomitë në zhvillim për të arritur nivelin e tyre më të lartë në 681 miliard \$ me një rritje qind 2 për. Ekonomitë në zhvillim duke zgjeruar epërsinë e vet në hyrjet globale. Kina u bë përfituesi më i madh në botë i IHD-ve. Në mesin e 10 përfituesve më të lartë të IHD-ve në botë, 5 janë në zhvillim (BQK, 2014).

IHD-të mund të kontribuojnë pozitivisht në rritjen dhe zhvillimin e vendeve në zhvillim nga kapitali duke sjellë punësim, teknologji, hyrjen në treg, dhe aftësitë menaxheriale IHD-të luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik afatgjatë të vendeve në zhvillim, me potencialin e tyre të madh për të krijuar vende pune, për të rritur produktivitetin, rritjen e eksporteve dhe transformimin e teknologjisë.

Një nga faktorët kryesorë që do të ndihmojë vendet në zhvillim në përshpejtimin apo mbajtjen e ritmit të zhvillimit të tyre ekonomik dhe social është që të kemi infrastrukturë me cilësi të mirë. Vendet në zhvillim kanë nevojë për investimet e huaja direkte për të arritur objektivat e tyre të rritjes, pasi ata dëshpërimisht kanë nevojë për kapital të huaj në mënyrë që të rrisin kursimet e tyre të brendshme. Prandaj, vendet në zhvillim kërkojnë investime urgjente që kanë për qëllim për të forcuar industrinë e infrastrukturës dhe

shërbimeve në fusha të tilla si uji, energjia elektrike, telekomunikacioni, transporti, ndertimtaria etj,

Edhe pse qeveritë, sektori privat dhe aktorë të tjerë në këto vende janë duke kontribuar në investimet në infrastrukturë, shuma e investimeve të nevojshme ende tejkalon kontributin e tyre. Vendet në zhvillim në përgjithësi investojnë 3-4% të GDP-së së tyre vjetore në infrastrukturë, ndërsa ato duhet të investojë një vlerë prej 7-9% për të arritur rritje të mirë ekonomike dhe uljen e varfërisë. Natyrisht, kjo rezulton në një boshllëk të madh në mes të vëllimit aktual të investimeve dhe çfarë është në të vërtetë e nevojshme.

Kosova dhe disa vende të tjera më pak të zhvilluara ka tërhequr më pak se rritja mesatare botërore e IHD-ve në vitin 2014, ndërkohë që daljet e IHD-ve kanë mbetur e përgjithshme. Një nga shqetësimet më të mëdha të Kosovës, aktualisht mbetet niveli i ulët i investimeve të huaja direkte, papunësisë së lartë dhe varfërisë. Shkalla e papunësisë vazhdon të jetë shqetësuese dhe me trendet negative. Shkalla e papunësisë në vitin 2014 është 35.3%. Shkalla e papunësisë është shumë më e lartë për femrat rreth 42%. Normat e rritjes ekonomike në vitet e fundit nuk mund të arrijnë të thithin forcën e punës për shkak të rritjes së saj, për shkak të strukturës së re të popullsisë. Struktura e popullsisë së Kosovës është e dominuar kryesisht nga të rinjtë të cilët janë të aftë për punë (*BQK, 2014*).

Në këtë drejtim, kapitalit të huaj, veçanërisht të IHD-ve, luajnë një rol të rëndësishëm në rritjen ekonomike. Rëndësia e IHD-ve është edhe më e madhe për Kosovën, ku kapitali i brendshëm është i paaftë për të përmbushur nevojat e mëdha për investime që dalin nga arsye ekonomike dhe jo-ekonomike, të tilla si:

- Procesi i transformimit ekonomik nga e planifikuar në ekonomi të hapur;
- Pasojat dhe dëmet e shkaktuara nga lufta në 1998 dhe 1999;
- Shfrytëzimi i furnizimit të madh dhe të vogël të krahut të punës;
- Ndërtimi i një imazhi ndërkombëtar të investimeve në Kosovë.

Vendet në zhvillim, dhe Kosova, gjatë tranzicionit kanë përjetuar një mungesë të kapitalit financiar vendas. Limiti i furnizimit me kapital vendas ishte larg nga të përmbushurit e

nevojës së madhe për këto investime të punës-krijuar. Në mënyrë për të kapërcyer këtë situatë, pavarësisht nga investimet e brendshme, këto vende urgjentisht të nevojshme për të tërhequr kapitalin e huaj.

Ka faktorë të ndryshëm ekonomik dhe jo-ekonomik që ndikojnë në nivelin e ulët të IHD-ve, si situata aktuale politike, madhësia e tregut, infrastruktura fizike, rendi dhe ligji, korrupsioni, etj,

Në vitin 2012 shuma e përgjithshme e IHD-ve në Kosovë ishte vetëm 291.1 milionë Euro, më pas në vitin 2013 u zvogëlua në 227.4 milionë Euro. Në vitin 2014 ka pasur një rritje të lehtë, duke e çuar totalin deri në 295.9 millione. Deri në fund të vitit 2015, niveli i fluksit të IHD-ve ka pasur një rritje pozitive në 310.5 milionë. Shuma aktuale e IHD është ende e ulët në krahasim me vendet e tjera të rajonit. Në këtë aspekt tërheqja e IHD-ve, së bashku me zhvillimin e kapitalit njerëzor mbetet një sfidë e madhe në vitet e ardhshme për qeverinë e Kosovës dhe organet e tjera përgjegjëse (*BQK, 2015*).

Rritja e shpejtë e IHD-ve mund të kontribuojë në rritjen ekonomike, zbutjen e papunësisë së lartë, transferimin e teknologjisë, rritjen e produktivitetit, qasje në tregjet e jashtme dhe rritjen e kapitalit njerëzor. Për më tepër, ia vlenë të përmendet se menjëherë pas luftës së vitit 1999, Kosova ka tërhequr të gjitha llojet e investimeve të huaja direkte dhe nuk ka pasur pothuajse asnjë kriter apo prioritet të vendosur nga qeveria.

Për të tërhequr sa më shumë investime të huaja, Kosova duhet të posedoj edhe kapital njerëzor. Ku në këtë rast Kosova ka një popullsi shumë të re, më e reja në Evropë (një e treta e popullsisë është nën moshën 16 vjeç) dhe emigracioni i lartë (i cili përbëhet nga rreth 15 % e popullsisë së përgjithshme prej 2.0 milion). Për më tepër, Republika e Kosovës është shteti i fundit që ka shpallur pavarësinë e saj (17 shkurt 2008) nga Serbia / ish-Federata e Jugosllavisë; kështu, duke e bërë Kosovën shtetin e fundit që nisë në rrugën e tranzicionit nga një vend komunist drejt ekonomisë së tregut (*KHDR, 2012*).

Ngjarje të tilla kanë pasur ndikim të madh në zhvillimin aktual ekonomik, tërheqjen IHD-ve dhe zhvillimin e kapitalit njerëzor në Kosovë. Sipas një studimi nga Organizata Ndërkombëtare e Punës, mbi 145,000 punëtorë kosovarë u pushuan nga puna në fillim të 1990-ës. Gjatë periudhës 1990-1995, prodhimi i kontraktuar nga 50% duke rënë në më pak

se US \$ 400 në frymë. Papunësia, duke qenë në 27% në vitin 1989, ka arritur nivelin e rreth 68% pak para luftës së vitit 1999. (KHDR, Raporti i Zhvillimit Njerzor në Kosovë, 2012)

Papunësia " veçanërisht e lartë në mesin e të rinjve të moshës 16-25 dhe femra, ndërsa rreth 70% të papunë ", janë të papunë afatgjatë. Nevoja për investime (vendore dhe ndërkombëtare) është e madhe. Aftësitë e brendshme të investimeve janë të kufizuara në Kosovë, për këtë arsye, FDI janë parë si zgjidhje e mirë për të kapërcyer papunësinë e lartë dhe ndoshta për të rritur mundësitë e investimeve. Megjithatë, njohuritë e kufizuara, aftësitë, kompetencat dhe sistemi arsimor mund të veprojnë si një pengesë e madhe për tërheqjen e investimeve të huaja maksimale (KHDR, 2012).

Duke pasur popullatën më të re në Evropë, për Kosovën mund të jetë një avantazh konkurrues, në aspektin e ofertës së punës dhe disponueshmërinë e kapitalit njerëzor, por në kohë të fundit, kjo është një sfidë e madhe për politikëbërësit, si për të kanalizuar në fuqinë punëtore potenciale në ekonomi. Një nga shqetësimet më të mëdha është se aftësitë dhe kompetencat e ofruara nga punëtorët nuk janë ato që janë të kërkuara nga kompanitë, duke sugjeruar nevojën për ndryshime të mëtejshme në sistemet e arsimit dhe trajnimit. Komuniteti i biznesit dhe ngritja akademike mund të jenë të dobishme për të krijuar lidhje më të ngushta dhe për të siguruar pajtueshmërinë në lidhje me pajtueshmërinë e aftësive dhe njohurive të fituara nga arsimi formal dhe nevojave të biznesit (lidhja: teori vs. praktikë).

Disa iniciativat janë ndërmarrë për të përmirësuar dhe për të reformuar sistemin e arsimit në Kosovë, por ato kanë rezultuar të pamjaftueshme. Një nga nevojat kryesore është për të përmirësuar monitorimin e prodhimit të sistemit në tërësi. Aftësitë e zotëruara nga punëtorët nuk janë ato që janë të kërkuara nga kompanitë, duke sugjeruar nevojën për ndryshime të mëtejshme në sistemet e arsimit dhe trajnimit.

4. METODOLOGJIA

Në këtë kapitull paraqitet qasja hulumtuese, strategjia hulumtuese dhe procesimi i të dhënave.

Metodologjia që është aplikuar gjatë hartimit të këtij punimi janë të përcaktuara nga vetë qëllimi i hulumtimit. Gjatë hartimit të këtij punimi, pra është shfrytëzuar literatura shkencore e një spektri të gjerë që ka të bëjë me fushën e këtij punimi.

Po ashtu janë shfrytëzuar edhe studimet e instituteve kërkimore-shkencore, raportet vjetore të institucioneve të ndryshme vendore, burim tjetër kanë qenë edhe portalet e ndryshme sociale të cilat ofrojnë shumë njohuri mbi Investimet e Huaja Direkte por edhe në përgjithësi për ekonominë. Burim tjetër që unë jam munduar ka qenë eksperiencia ime e kaluar gjatë plot tri (3) viteve në fakultet dhe jam munduar të shfaq të gjitha njohuritë të cilat kanë pasur të bëjnë me temën në fjalë.

Për rezultatin e këtij punimi është përdorur një metodologji që konsiston në mbledhjen e të dhënave sekondare. Është bërë një analizë për investimet e huaja direkte në Kosovë, si dhe janë dhënë detaje për vlerën e investimeve direkte në Kosovë po ashtu edhe për ndikimin që ka kapitalit njerëzor për thithjen e investimeve.

5. PREZANTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE

Në këtë kapitull diskutohen rezultatet e fituara nga literatura e shqyrtuar në fillim diskutohet për investimet e huaja direkte në republikën e Kosovës në përgjithësi, shpërndarja e investimeve të huaja direkte në sektore të ndryshme dhe kret në fund për ndikimin e kapitalit njerzor në investimet e huaja direkte.

5.1 Ecuria e Investimeve të Huaja Direkte në Kosovë

Kosova ballfaqohet me burime të reduktura për financimin e investimeve, në kushtet kur domosdo përballet me presionin dhe nevojen për të zgjidhur problemin e papaunësisë (norma e vlerësuar e papunësisë 45-50%) dhe përmisuar infrastrukturën publike. Gjendja aktuale në sektorin e energjetikës, telekomunikimeve dhe transportit rrugor mund të konsiderohet si faktorë limitues në zhvillim. Aktiviteti investues i bizneseve private në periudhen e pasluftës ka gjeneruar rritje të konsiderushme ekonomike dhe të punësimit.

Në këto kushte, krijuesit e politikave ekonomike sfidohen me nevojen e nxitjes së investimeve të reja. Prandej krijimi një ambienti miqësor afarist dhe ambientit adekuat institucional për tërheqjen e investimeve të jashtme direkte imponohet si një nga prioritetet më të rëndësishme të politikave ekonomike dhe reformës ekonomike. Është e kuptueshme se vetëm investimet e huaja direkte nuk mund t'i shpejtojnë aktivitetet të domosdoshme investuese. Synimi duhet të jetë që ato të bëhen një burim i rëndësishëm me burimet e tjera të financimit.

Kosova ka një agjenci të dedikuar e cila gjendet në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, për promovimin e investimeve të huaja direkte: APIK – Agjencia për Promovimin e Investimeve në Kosovë.

Rritja e IHD-ve është rezultat i fluksit më të lartë të hyrjes së IHD-ve ndërsa dallimi me vitin paraprak është edhe për faktin se viti 2014 ishte karakterizuar me shpërndarje të superdividentës dhe me shitje të aksioneve të kompanive të huaja. Edhe investimet direkte

të rezidentëve kosovarë në vende tjera ishin më të larta krahasuar me vitin paraprak dhe arritën vlerën prej 20.9 milionë euro (16.9 milionë euro në vitin 2014). Investimet direkte të rezidentëve kosovarë jashtë ekonomisë së Kosovës janë kryesisht investime kapitale, të cilat në të shumtën e rasteve janë blerje e patundshmërive në vendet e rajonit por edhe në Gjermani dhe Zvicër. Tabela e mëposhtme tregon nivelin e IHD-ve në Kosovë mes viteve 2007 deri me 2015. (BQK, 2015).

Tabela 1. Investimet e huaja direkte 2007 –2015 (në mil EUR)

| <i>Viti</i> | <i>2007</i> | <i>2008</i> | <i>2009</i> | <i>2010</i> | <i>2011</i> | <i>2012</i> | <i>2013</i> | <i>2014</i> | <i>2015</i> |
|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|
| <i>IHD</i> | 440,7 | 366,5 | 287,4 | 365,8 | 393,9 | 291,1 | 277,4 | 295,9 | 310,4 |

Burimi: BQK, 2015

Pavarësisht një rritjeje në vitet 2009-2011 gjatë viteve të fundit Kosova ka tërhequr më pak investimet te huaja direkte. Shihet qartë se në vitin 2013 ka një rënie prej 14 milion më pak krahasuar me vitin paraprak, në vitin 2014 ka një rritje nga 277 milion që ishte në 2013 në 295.9 milion. Ndërsa në vitin e fundit Kosova arrinë të perfitojë 310.4 milion investime të huaja. Sektorët kryesorë që tërheqin investime janë shërbimet financiare, ndërtimtaria, pasuritë e patundshme dhe prodhimi, me një rritje në investimet e vitit 2014 të cilat erdhën kryesisht nga Turqia (BQK, 2015).

5.2 Promovimi i Kosoves si vend për investime

Sipas të dhënave të Regjistrimit të Biznesit për vitin 2010, në Kosovë kishin investuar 3,523 kompani me pronësi të huaj dhe të përzier. Në vitin 2013 dhe 2015, Patundshmëria, Ndërtimtaria, Energjetika dhe shërbimet financiare tërhoqën pjesën më të madhe të IHD-ve. Ka një numër pikash marketingu, të cilat Agjencia për Promovimin e Investimeve (APIK) i përdor si atraksione kryesore për investitorët e huaj potencialë dhe ato janë:

- Monedha euro kosto të ulëta transaksioni brenda Eurozonës.

- Shpenzime pune mesatare mujore të ulëta, rreth 250 euro.
- Vendndodhje strategjike me lidhje me qytetet kryesore europiane dhe një rrjet rrugor i përmirësuar.
- Qasje të lirë në një treg prej 520 milion konsumatorësh nëpërmjet regjimit të Preferencave Tregtare Autonome të BE-së dhe marrëveshjes me CEFTA-n.
- Popullsi më të re në Evropë - 70% e popullsisë është nën 35 vjeç dhe 50 % nën 25.
- Nivel të lartë njohjeje të gjuhëve të huaja.
- Fuqi punëtore të disponueshme, të motivuar dhe të arsimuar
- Taksa shumë të ulëta – shkalla e tatimit të korporatës është përgjysmuar në vitin 2009 nga 20 në 10 %.
- Norma tatimore të ulëta për të ardhurat personale (0 deri në 10 %)
- Nuk ka detyrime importi mbi importimin e mallrave kapitale dhe inputeve bujqësore
- Normë TVSH-je prej 8% për produkte bazë dhe 18% për produktet e tjera.
- Kontribute të ulëta shoqërore për pagat
- Qeveri që mbështet IHD-të me nisje të shpejtë operacionesh
- Sistem ligjor modern të pajtueshëm me atë të BE
- Sistem të shëndetshëm bankar – sistem me dy nivele me Bankën Qendrore të Kosovës dhe 8 banka private.

Agjencia për Promovimin e Investimeve në Kosovo (APIK) zhvilloi një Strategji për Promovimin e Investimeve 2010 – 2015, e cila është bazuar në dy sektorë bërthamë të synuar. I pari ishte:

- procesi i transferimit të biznesit/qendra thirrjesh telefonike/qendrat e shërbimeve të përbashkëta/ shërbimet e sigurimit të IT-së
- komponentë automotivë
- shërbimet e kontraktimit elektronik të fabrikimit/ komponentëve elektronikë
- agrobiznesi, duke përfshirë përpunimin dhe paketimin

Sektori i saj i dytë bërthamë i synuar ishte:

- infrastruktura e turizmit

- produktet pyjore dhe përpunimi i drurit
- gurë dekorues dhe materiale ndërtimi
- energjia

Nëse IHD-të duhet të vazhdojnë trendin në rritje të kohëve të fundit, ekziston nevoja që të jipet siguri që industrinë kryesore e me punë intensive të tërhiqen në Kosovë; që investitorëve të huaj t'u ofrohen iniciativat e duhura dhe që mjedisi rregullator dhe legjislativ të jenë të favorshëm për IHD-të. Përveç kësaj, qeveria duhet medoemos të bëjë më shumë për të luftuar korrupsionin.

5.3 Shpërndarja e investimeve sipas sektorëve

Investimet në Kosovë sikurse edhe në vendet tjera të rajonit janë të shpërndarë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Megjithatë, vetëm një pjesë e vogël e investimeve janë bërë në sektorin e prodhimit, derisa pjesa tjetër është e ndarë barabartë në mes ndërtimtarisë, patundshmëri dhe shërbimeve financiare (këta sektorë bëjnë pjesën më të madhe të investimeve totale). Shpërndarja e tyre në Kosovë nëpër sektorë është e njëjtë me shpërndarjen e bizneseve në Kosovë sipas sektorëve.

Më poshtë mund të shohim shpërndarjen e IHD-ve nga 2007 deri në vitin 2015 sipas sektorëve ku në vitin 2013 shihet se 48.5% të të gjitha investimeve e përbën Patundshmëria po ashtu rol të rëndësishëm ka edhe sektori i Energjetikës me 17.4, Shërbimet Tregtare me 6.2% dhe Ndërtimtaria me 20.8%, Industria me 4% dhe sektorët tjerë me më pak të përfshira.

Njëjtë si në vitin 2013 po ashtu edhe në vitin 2014 sektori ku ka më së shumti investime është sektori i patundshmërisë, ku merr pjesë me 94% ku edhe e përbën pjesën më të madhe të investimeve, shërbimet financiare 27.7%, energjetika 8.8% dhe sektorët tjerë (*BQK, 2014*).

Edhe në vitin 2015 njëjtë, patundshmëria përbën pjesën kryesore të investimeve me 58.2%, shërbimet financiare me 19.7%, ndërtimtaria me 14.2%, energjetika me 3.6% dhe përqindje më të vogël janë minierat dhe shërbimet tregtare dhe sektorët tjerë.

Tabela 2. Investimet e huaja direkte 2007 - 2015 sipas sektorëve (vlera në ml E).

| <i>Përshkrimi</i> | <i>2007</i> | <i>2008</i> | <i>2009</i> | <i>2010</i> | <i>2011</i> | <i>2012</i> | <i>2013</i> | <i>2014</i> | <i>2015</i> |
|----------------------------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|
| <i>Bujqësia</i> | 7,9 | 8,5 | 13,1 | 0,9 | 0,6 | 0,3 | 0,4 | 0,2 | 0,9 |
| <i>Minierat</i> | 41,5 | 17,4 | 7 | 17,7 | -5,2 | -25 | -14,1 | 4,2 | -24,6 |
| <i>Industria</i> | 74,8 | 53,7 | 57,6 | 101,1 | 46,9 | 27,4 | 11,5 | -34 | 23,1 |
| <i>Energjetika</i> | 2,5 | 16,7 | 8,7 | - | 0,2 | 2,2 | 48,8 | 13,4 | 11,9 |
| <i>Ndërtimi</i> | 5,2 | 13,5 | 35,5 | 54,2 | 133,1 | 31,1 | 17,3 | -19,9 | 46,3 |
| <i>Shërbimet tregtare</i> | 12,7 | 10,1 | 16,2 | 6,8 | 11,6 | 9,3 | 14,6 | 8,4 | 13 |
| <i>Hotele dhe Restorante</i> | 12,7 | 2,1 | 2,4 | - | 0,2 | 0,5 | 0,8 | 0,4 | -0,1 |
| <i>Transporti dhe Komunikimi</i> | 129,2 | 51 | 21,9 | -15,9 | 29 | 32,4 | 51 | -9,1 | -6,2 |
| <i>Shërbime Financiare</i> | 102 | 109,6 | 75,3 | 39,4 | 33 | 22,4 | 4,4 | 41,9 | 64,3 |
| <i>Patundshmëria, Qiradhënia</i> | 30,9 | 62,2 | 43,9 | 75,5 | 60,5 | 115,7 | 136,1 | 142,1 | 189,6 |
| <i>Shërbimet tjera</i> | 4,5 | 2,1 | 2,7 | 1,3 | 11,3 | 1,8 | 3,3 | 2,2 | 4,5 |
| <i>Aktivitetet tjera</i> | 16,9 | 23 | 11,3 | 87,6 | 63,2 | 11 | 6,2 | 1,4 | 1,5 |
| <i>Gjithsej</i> | 440,7 | 369,9 | 295,5 | 368,5 | 384,4 | 229,1 | 280,2 | 151,2 | 324,4 |

Burimi: BQK, 2015

5.4 Shpërndarja e investimeve sipas shteteve

Sipas Open Data Albania që po përditëson të dhëna për Investime të Huaja Direkte (IHD), në Kosovë sipas shtetit të origjinës. Investimet e huaja direkte janë tregues i rëndësishëm i flukseve të kapitalit dhe zhvillimit të ekonomisë.

Gjatë vitit 2013 rezultojnë në total 259.2 milionë euro Investime të Huaja Direkte të vitit, duke shënuar ngritje kundrejt 228.6,9 milionë euro që ishin një vit më parë. Shteti nga ku e kanë origjinën pjesa më e madhe e IHD-ve në Kosovë për vitin 2013 është Turqia me 82,7 milion euro, po ashtu edhe Zvicra me 41.6 milion, Gjermania me 21.6 milion. Shtete të tjera me peshë sa i takon IHD-ve janë Shqipëria me 19.2 milion, Britani e Madhe me 10.6 milion dhe shtetet e tjera. Holanda shënon tërheqje me -15.4 milion euro IHD gjatë vitit 2013, në një kohë që një vit krahasuar me vitin 2012.

Në vitin 2014 tri (3) shtetet që përbëjnë pjesën më të madhe të Investimeve e përbëjnë Zvicra me 38.2 milion, Austria me 30.3 milion dhe Gjermani me 29,4 milion, Britania e Madhe shënon terheqje me 39.5 milion krahasuar me vitin paraprak.

Njëjtë si në vitin paraprak edhe në vitin 2015 Zvicra prinë me investime në Kosovë ku merr pjesë me 40.5 milion, Turqia me 28.8, Austria merr pjesë me 26 milion dhe shtetet e tjera me më pak. Për më shumë shih tabelën 3 (BQK, 2014).

Tabela 3. Investimet e huaja direkte 2007 –2015 sipas vendit të origjines (në mil EUR).

| Rajoni Vendi | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 |
|---------------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|-------------|
| Austria | 35,39 | 51,3 | 15,5 | 21,14 | 19,56 | 0,38 | 10,7 | 30,3 | 26 |
| Gjermania | 48,14 | 43,97 | 75,15 | 91,54 | 66,64 | 49,51 | 21,67 | 29,4 | 10 |
| Slllovenia | 56,17 | 44,34 | 50,78 | 33,97 | 16,21 | 9,29 | 7,03 | -9,4 | 2,1 |
| Britania e Madhe | 116,16 | 36,65 | 6,16 | 38,86 | 80,1 | 14,31 | 10,66 | -39,5 | 17 |
| Zvicra | 9,74 | 32,09 | 22,71 | 35,1 | 30,93 | 43,77 | 41,68 | 38,2 | 40,5 |
| Turqia | 5,44 | 23,78 | 14,49 | 4,9 | 34,69 | 65,55 | 82,73 | 20 | 28,8 |
| Holanda | 41,24 | 22,47 | 15,07 | 14,54 | 14,19 | - | - | -7,8 | -11,6 |
| Shqipëria | 3,44 | 21,85 | 23,32 | 20,25 | 11,19 | 4,74 | 19,28 | 20,4 | 16,2 |
| Serbia | - | 5,54 | 0,63 | 0,43 | 0,36 | 0,37 | 5,69 | 2,4 | 0,4 |
| Shtetet e Bashkuara | 8,81 | 4,79 | 11,85 | 12,58 | 14,32 | 10,78 | 12,7 | 14,7 | 12,8 |
| Franca | 8,56 | 3,48 | 6,03 | 3,85 | 0,21 | 6,3 | 3,8 | 3,3 | 1,6 |
| Maqedonia | 0,39 | 1,98 | 1,52 | 1,8 | 5,79 | 1,19 | 4,65 | 3,2 | 1,1 |
| Kroacia | 5,78 | 0,65 | 0,67 | 1,8 | 2,88 | 0,38 | 1,34 | 1,1 | 1,8 |
| Qipro | 0,1 | 0,25 | 0,31 | 0,02 | 1,01 | 0,31 | 0,26 | -0,3 | - |
| Norvegjia | 0,55 | 0,13 | 2,47 | 3,3 | 2,47 | 2,86 | 4,7 | 5,9 | 1,7 |
| Itali | 5,47 | 0,06 | 5,97 | 6,6 | 1,68 | 4,38 | 8,73 | 3,3 | 3,4 |
| Greqi | 2,31 | 0,03 | 0,02 | 5,89 | 0,37 | 0,28 | -0,38 | -0,6 | -0,3 |
| Te tjera | 93,03 | 73,08 | 34,78 | 69,25 | 91,27 | 40,23 | 39,27 | 36,6 | 11 |
| TOTALI | 440,7 | 366,4 | 287,4 | 365,8 | 393,8 | 228,6 | 259,0 | 151,2 | 163, |

Burimi: BQK, 2015

5.5 Investimet e Huaja Direkte dhe Roli i Kapitalit Njerëzor

Në këtë kapitull do të diskutojmë për rëndësinë e kapitalit njerëzor në raport me investimet e huaja direkte, ndryshimet që duhen të bëhen në arsim, barrierat që hasin kompanit e huaj, rëndësia e kapitalit njerëzor në procesin e vendimmarrjes për të investuar në Kosovë, arsyet për të investuar në Kosovë, dhe krejt në fund për rolin dhe ndikimin e kapitalit njerëzor në investimet e huaja direkte.

Kapitali njerëzor është një faktor i rëndësishëm që favorizon ndërtimin e ekonomisë të bazuar në dije. Sipas De La Fuente dhe Ciccone, kapitali njerëzor do të thotë "njohuritë dhe aftësitë e mishëruara në njerëzit që janë fituar me anë të shkollimit, trajnimit dhe përvojës, dhe janë të dobishme në prodhimin e mallrave, shërbimeve, dhe njohuritë më tej". Kështu që është një pjesë e rëndësishme e ekonomisë dhe kjo nënkupton që duhet të ketë njerëz të kualifikuar për punë. Kapitali Njerëzor është konsideruar një nga forcat kryesore lëvizëse të inovacionit dhe zhvillimit. Rezultatet e hulumtimit të Bankës Botërore nxjerrin në pah rolin e rëndësishëm të burimeve njerëzore në nxitjen e rritjes ekonomike. I njëjti studim zbuloi se pjesa e tyre në pasurinë botërore është 64%.

Investimi në arsim dhe kapitalin njerëzor është i rëndësishëm për krijimin e klimës së mirë për investime. Është theksuar se arritja e një niveli të caktuar minimal të arsimit është parakusht për një vend për të tërhequr dhe mbajtur investime të huaja direkte dhe të maksimizuar efektet indirekte të lidhura me kapitalin njerëzor dhe që rezultojnë nga prania e bizneseve me kapital të huaj.

Rezultatet e disa studimeve të kryera në rajon kanë treguar se kapitali njerëzor është një faktor i rëndësishëm, i cili tërheq IHD. Kjo është veçanërisht e rëndësishme nga pikëpamja e përfitimeve që mund të arrihen nga ekonomia e rajonit nga investimet e huaja direkte.

5.6 Kapitali Njerëzor dhe Lidhja me Investimet e Huaja Direkte

Në hulumtimin e realizuar nga (Zeqiri, 2013) me institucionet që investuan në Kosovë me pyetjen për "Rëndësinë dhe prioritizimin e kapitalit njerëzor në procesin e vendimmarrjes për

të investuar në Kosovë”. Ku në përgjigjet, Po, Jo, dhe i pjesshëm gjetjet tregojnë se 70% e investitorit të huaj kanë prioritet kapitalit njerëzor, si një faktor i rëndësishëm që shoqëron vendimet për investime, 23% është i pjesshëm dhe 7% është përgjigjja me Jo. Shih grafikun 1 (Zeqiri, 2013).




Figura 1. Rëndësinë dhe prioritetimin e kapitalit njerëzor në procesin e vendimmarrjes për të investuar në Kosovë.

Burimi: Zeqiri, 2013

Në të njëjtin hulumtim, në pyetjen ”Arsyet për të investuat në Kosovë” një nga faktorët kryesorë është renditur “kosto e ulët e punës” me 17% nga e përgjithshmja, “konkurenca e vogël” po ashtu radhitet si faktorë i rëndësishëm me 17%, “mundësit e tregut të konsumit” me 16%. Rol të rëndësishëm luan edhe “kostoja e kapitalit” me 13%, “kualiteti i kapitalit njerëzor” me 11%, Një tjetër arsye e rëndësishme ishte “lokacioni atraktiv” me 11%. Arsyet e tjera ishin edhe “burimet neutrale”, “mikpritja lokale”, me 5%. Më poshtë mund të shihen edhe të paraqitur në mënyrë grafike.




Figura 2. Arsyet për të investuar në Kosovë.

Burimi: Zeqiri, 2013




Figura 3. Barrierat që mund të zvogëlojnë numrin e kompanive që mund të investojnë në Kosovë.

Burimi: BQK 2015

Siç mund të shihet nga Grafikun 3, 25% e kompanive të IHD-ve treguan “korrupsionin” si pengesë të madhe për rritjen e investimeve të tyre në vend. Pengesë e dytë u rendit “Tregu i Vogël” me 17% e ndjekur nga “Politika jo Stabile” me 16 % dhe “Procedurat Burokratike” 16%. Po ashtu edhe “Norma të Larta të Interesit” me 13% dhe “Rendi dhe Ligji” me 13%, kanë një peshë të rëndësishme. Është shumë e rëndësishme të theksohet se kompanitë e IHD-ve nuk kanë theksuar “26ire26em me kapitalin njerëzor” si shkak ose pengesë për investime.




Figura 4. A duhen trajnime shtesë për punëtorët e rinjë në kompanitë që bëjnë investime të huaja direkte (IHD).

Burimi: Zeqiri, 2013

Siç mund të shihet në Grafikun 4, 93% e kompanive të IHD-ve u përgjigjen me “Po” në pyetjen, se “A duhen trajnime shtesë për punëtorët e rinjë”, 3% ishin me përgjigjen “Jo”, dhe vetëm 4% ishin me përgjigjen “Vetëm për aftësi të Veçanta”.




Figura 5. Në procesin e punësimit të kandidatëve në Kosovë kë do të punsëonit të parin.

Burimi: Zeqiri, 2013

Bazuar në punësimin e punëtorve nga kompanit që investojnë në Kosovë, dhe sipas përzgjedhjes së kandidatëve për punë, kompanitë e IHD-ve kanë në plane të 27ire kandidatët që e kanë kryer apo kanë diplomuar në universitet jashtë vendit me (80%); pastaj janë kandidatët që e kanë kryer universitetin në universitet publike (57%), dhe zgjedhja e fundit ishin kandidatët apo të diplomuarit nga universitetet private (vetëm 20%).

Kapitali njerëzor është një përcaktues i rëndësishëm në thithjen e investimeve të huaja direkte. Në hulumtimin se sa është i rëndësishëm kapitali njerëzor në thithjen e IHD-ve, 60% e kompanive pranojnë se prania e kapitalit njerëzor është “shumë e rëndësishme”, 30% e kompanive pranojnë se prania e kapitalit njerëzor është “e rëndësishme” Numri i kompanive të IHD-ve, respektivisht përfaqësuesit të IHD-ve institucionale duke qenë “pak e rëndësishme” ishte shumë i vogël me (10%), ndërkohë që asnjë nga kompanitë nuk pajtohen që prania e kapitali njerzor është “jo e rëndësishme” apo “aspak e rëndësishme”. Më detajisht shih grafikun 6.




Figura 6. Roli dhe ndikimi i kapitalit njerëzor në investimet e huaja direkte.

Burimi: Zeqiri, 2013




Figura 7. Ndryshimet që duhet të bëhen në sistemin e arsimit rekomanduar nga institucionet që investojnë në Kosovë.

Burimi: Zeqiri, 2013

Ndryshimet e ardhshme më të rëndësishme arsimore (të rekomanduara nga 42% e kompanive të IHD-ve) janë: “krijimi i lidhjeve të forta në mes institucioneve arsimore dhe bizneseve”, e ndjekur nga rekomandimi për “hapjen e shkollave profesionale dhe të specializara” me (21%) dhe “përmisimi i cilësisë së mësimdhënësve dhe profesorëve” (16%).

Hulumtimet zbulojnë se rekomandimi për “përshtatjen e praktikave që e kanë përdorur vendet e zhvilluara” dhe “puna më praktikë gjatë studimeve” nuk ishin shumë të theksuara të dyja këto rekomandime ishin me (11%).

Nga kjo mundë të kuptojmë që nevojitet që të rishikohen programet mësimore dhe metodat në mënyrë që studentët të cilët diplomojnë, t’i përshtaten më 29ire kërkesave të tregut të punës. Një problem tjetër që ka Kosova si treg i vogël dhe me një ekonomi të varfër nuk mund t’i absorbojë të gjithë ata që diplomojnë, prandaj ne duhet të llogarisim se njerëzit tanë duhet të jenë të përgatitur për një treg më të gjerë se Kosova.

6. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIMET

Në këtë kapitull janë përmbledhur pikat kryesore nga i gjithë punimi është bërë një përmbledhje e gjithë temës po ashtu edhe jepen rekomandime në lidhje me ndryshimet që duhet të bëjë Kosova apo institucionet e Kosovës në lidhje me Investimet e Huaja Direkte.

Edhe pse mbetin sfida të rëndësishme për përmirësim të mëtejshëm të mjedisit të bërit biznes, Kosova u ofron investitorëve të huaj shumë potenciale të cilat ia vlejshme të eksplorojnë. Një fuqi punëtore të re dhe të motivuar, regjime të ulëta tatimore, sistemi i shëndoshë financiar, si dhe qasje në një treg prej mbi 500 milion konsumatorësh (përmes disa marrëveshjeve për tregti të lirë prej të cilave përfiton Kosova), janë vetëm disa nga përfitimet nga të cilat investitorët e huaj mund të bazojnë investimet e tyre.

Kosova mund të bëhet një vend tërheqës për investitorët e huaj për të bërë biznes. Megjithatë, duhet të theksohet se tërheqja e IHD-ve, përveç stimujve monetarë dhe fiskal, duhet të shoqërohet me zhvillimin e vazhdueshëm dhe rritjen e nivelit të kapitalit njerëzor, si një parakusht për të tërhequr të drejtën IHD-ve. Sipas raportit të Bankës Botërore "Doing Business 2011", Kosova mund të bëjë më shumë krahasuar me vendet fqinje, kur bëhet fjalë për kosto të ulët të punës dhe thjeshtësinë e punësimit e punonjësve të rinj. Me koston mesatare të punës mujore rreth 330 €, përparësi kryesore e fuqisë punëtore në tërheqjen e IHD-ve mbetet kostoja e saj e ulët.

Duke pasur parasysh se Kosova është shumë e populluar me të rinjtë, por përballet me papunësi të lartë, është shumë e rëndësishme që të krijohen ura të forta në mes të sistemit të arsimit dhe tërheqjes së IHD-ve. Kosova ka nevojë për një shkollim themelor për të gjithë punëtorët e rritur për të treguar se vendi ka një klimë të shëndoshë për investime. Në mjediset e sotme të biznesit, lidhja në mes të teorisë së shkollimit dhe praktikës në biznes është shumë e qendrore.

Konstatimi kryesor është që, në të vërtetë, kapitali njerëzor luanë një rolë pozitiv dhe të rëndësishëm në tërheqjen e IHD-ve. Përfundimi kryesor i jonë është se formimi i kapitalit njerëzor në Kosovë duhet ti jepet një rëndësi e veçantë. Studimi ka dhënë një vlerësim të fortë të vlerës së kapitalit njerëzor nga investitorët e huaj që investojnë në Kosovë.

Përveç kujdesit në lidhje me perspektivat e tyre për shkak të investimeve në Kosovë, investitorët e huaj shpesh mbështeten në informacionin e shpërndarë nga përfaqësuesit e institucioneve të IHD-ve. Bazuar në rezultatet e hulumtimeve të ndryshme dhe vëzhgimet e studiueseve, mundë të adresohen disa rekomandime që mund të shihen më poshtë.

- ***Duke ri-hartuar një paketë të re me lehtësira fiskale dhe financiare të dedikuara për investitorët e huaj.*** Fokusi i stimujve të reja duhet të jetë në investimet e huaja direkte që ndihmojnë për të luftuar papunësinë e lartë në Kosovë, duke u fokusuar në investimet e huaja direkte që mund të thithin numër të lartë të të punësuarve. Stimujt fiskale dhe financiare duhet "lidhur me cilësinë e investimit, e matur në bazë të kriterëve transparente (Zeqiri, 2013).
- ***Strategjia kombëtare kundër korrupsionit.*** Zbatimi i kësaj strategjie kombëtare mund të përmirësojë perceptimet e investitorëve të huaj dhe të emigrantëve në lidhje me mjedisin e biznesit. Politikat e tilla do të kenë ndikime të rëndësishme, ata do të kenë më shumë gjasa për të investuar më shumë në Kosovë. Së dyti, politikat e tilla bëjnë që emigrantët të sjellin teknologji të reja dhe përvoja të reja në Kosovë.
- ***Rritja e investimeve publike dhe private në sistemet e arsimit dhe të trajnimit.*** Në kushtet e investimeve publike dhe private në arsim dhe trajnim, është urgjente që të bëhet një shpërndarje më e mire e burimeve. Investimet në Kosovës krahasuar me vendet e tjera të rajonit, duke marrë parasysh popullsinë e re, shpenzimet për arsimin janë të ulta. Kjo nënkupton që palët e interesuara private duhet të ofrojnë më shumë në aspektin e trajnimit dhe edukimit (Zeqiri, 2013).
- ***Norma më të mira të kamatës*** – duke marrë parasysh se normat e kamatës në Kosovo janë shumë të larta, bazuar në të dhënat e fundit të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) shihet se në vitin 2015, norma e interesit në kredi ishte 8,9 % (BQK 2015).
- ***Zhvillimi i sistemit informativ*** dhe statistikave adekuate mbi rrjedhën dhe analizën e trendeve të investimeve të huaja direkte, do të ishte njëra prej aktiviteteve të rëndësishme të Qeverisë, e sidomos e Entit Statistikor të Kosovës.

7. REFERENCAT

Baghirzade, N. (2012) *The Impact of Foreign Direct Investment on Human Development*.

BQK. (2010) *Raporti Vjetor*. Prishtinë: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

BQK. (2012) *Raporti Vjetor*. Prishtinë: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

Baghirzade, N. (2012) *The Impact of Foreign Direct Investment on Human Development*.

BQK. (2010) *Raporti Vjetor*. Prishtinë: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

BQK. (2012) *Raporti Vjetor*. Prishtinë: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

BQK. (2014) *Raporti i zhvillimeve*. Prishtinë: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

BQK. (2015) *Raporti Vjetor*.

Čaršimamović, N. (2011) *Impact of Austerity Measures on Investment Programmes in the Western Balkans*.

Development, T. I. (2014) *Doing Business*.

Georgiana, R. (2011) *The Impact of Foreign Direct Investments on Labour Productivity. Romanian Economic Journal*.

Group, D. (2010) *Raporti i zhvillimit njerëzor në Kosovë 2010* . Prishtinë: Swiss Cooperation of Kosovo.

Shenkar, H. (2007) *FDI Theory and Applicatio*.

Hoti, A. (2004) *Human Capital and Unemployment in Transition Economies*.

KHDR. (2008) *Shoqëria civile dhe zhvillimi*. Prishtinë: KHDR.

KHDR. (2012) *Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë*. Prishtinë: KHDR.

- Kosovo, E. I. (2011) *Investing In Kosovo*.
- Lim, G. (2001) *Determinants of, and the Relation Between, FDI and Growth*.
- Lima, D. (2008) *Advantages of Kosovo in Foreign Direct Investments* .
- Lipsey, R. E. (2003) *Foreign Direct Investment and the Operations*.
- Maher. (2001) *Foreign Direct Investments And The Multinational Corporatio*.
- Michill, J. (2001) *The Impact of Foreign Direct Investment on Human Capital Enhancement in Developing Countries*.
- Moosa, I. (2002) *Foreign Direct Investments*.
- Ndeffo, L. N. (2010) *Foreign Direct Investments and Human Capital Development*.
- Riinvest. (2002) *Raporti hulumtues lidhur me zhvillimin ekonomik lokal*. Prishtinë: Instituti Per Hulumtime Zhvillimore.
- RZHNK. (2014) *Migrimi si forcë për zhvillim*. Prishtinë.
- Shenkar. (2007) *FDI Theory and Applicatio*.
- Subbarao, S. (2008) *FDI and Human Capital Development*.
- Zeqiri, N. (2013) *The Impact of Human Capital in Attracting Foreign Direct Investments*.